

FJALA E DEPUTETIT XHELAL MZIU

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Prej disa javësh janë lëshuar me gjithë arsenalin e propagandës për ta konsideruar buxhetin e vitit 2022 si më i madhi i 30 vjetëve të fundit dhe me parametrat më shpresë plotë. Çudi! Pse, a ka ndonjë buxhet që nuk ka pasur rritje progresive në shifra të buxhetit? A mund të ma thoni, se ju mbase dini më shumë sesa dimë ne? Unë e di që jo, por ju thjesht me propagandë kërkoni t'i gënjeni shqiptarët. Të dashur shqiptarë, mos u gënjeni nga fasada. Ky buxhet që ka sjellë sot rilindja është buxheti i oligarkëve që nëpërmjet PPP-ve marrin shumicën e taksave të shqiptarëve. Në këtë projekt ju parashikoni një rritje ekonomike ndër më të voglat në këta 30 vjet, vetëm me 4,2%. Propaganda trumbeton një rritje të prodhimit të brendshëm bruto me 7,2% ose 537 milionë. Pyetja që shtrohet është: nga është parashikuar kjo rritje? Sigurisht, jo nga nxitja e ekonomisë dhe zhvillimi i sektorit prodhues në vend dhe as nga rritja e numrit të bizneseve. Kjo rritje, të dashur qytetarë, vjen kryesisht nga taksat tuaja, nga tatimet e biznesit dhe sidomos nga rritja e akcizës për disa produkte jetike për ekonominë familjare dhe biznesin. Investimet publike në projektin tuaj të mjerimit të shqiptarëve do të zënë 6,4% të PBBsë, së bashku me rindërtimin dhe çmimet e saj marramendëse, me koncensionet ose siç i njohin shqiptarët PPP-të korruptive.

Pra, investimet publike do të jenë 19 miliardë lekë më pak sesa buxheti i vitit 2020. Buxheti për investimet për vitin 2022 do të jetë në vlerë absolute më i vogël sesa buxheti i viteve 2008, 2009 dhe me një rritjet me bazë vjetore poshtë mesatares 30-vjeçare. Buxheti për pushtetin vendor, edhe pse kanë kaluar 7 kompetencat, vazhdon të jetë në nivelin më të ulët, krahasuar edhe me të kaluarën e Shqipërisë dhe me vendet e rajonit me vetëm 2,1% të GDPsë, në një kohë që në vitin 2013 premtuar se do të ishte 5%, pra më shumë sesa 2,5 herë nga ajo që ju kishit planifikuar ose keni realizuar në vitin 2020. U premtua se do të kurseheshin 80 milionë euro nga reforma territoriale. A e dini ju që sot ka 2 herë më shumë punonjës në 61 bashkitë dhe se buxheti i këtyre bashkive është 3 herë më shumë? Pra, i gjithë ky fond shkon për patronazhistët e 25 prillit. Administrata publike sot në Shqipëri është mbi 185 mijë ose 25 mijë të punësuar (patronazhistë kryesisht) vetëm 3 vjetët e fundit. Jemi vendi i 4-t në Europë me përqindjen më të lartë të të punësuarve publikë dhe vijmë fiks pas Norvegjisë, Suedisë dhe Danimarkës me 26,5% ose 2 herë më shumë sesa Gjermania, Italia dhe rajoni përreth. Bujqësia, sektori kryesor në Shqipëri, ka buxhetin më të vogël se viti 2020 – 2021. Asnjë investim nuk do të bëhet në qarkun e Dibrës, edhe pse ishte premtuar që në vitin 2013 që nuk do të ngelte asnjë parcelë pa u vaditur, zero lekë në 8 vjet, po kështu ka filluar edhe viti i 9-të. Qeveria do të bëjë rritje pagash vetëm 5 deri në 6% të pagës së funksionit, por kjo rritje nuk mjafton as për inflacionin, që është 2,8% për vitin që vjen, madje kjo rritje nuk fillon as më 1 janar, por fillon më 1 korrik, vërtet një tjetër skandal i kësaj qeverie.

Në buxhetin tuaj të propagandës ka çudira të tjera. A e dini ju, të dashur qytetarë, se arsimi zë vetëm 2,6 të GDP-së nga 5%, që ishte planifikuar ose ishte premtuar në vitin 2013? Në vitin 2013-të qeveria e Edi Ramës premtoi 5%-in, por sot e ka katandisur në 2,6% në letra dhe, në fakt, do të jetë më pak sesa aq. Sistemi arsimor sot lëngon, mjafton të shohësh vetëm qarkun e Dibrës, ku infrastruktura

arsimore në Dibër është vërtet mjerane, pa shkolla ose me shkolla pa dyer, dritare dhe ngrohje. Ky është standardi që ju keni krijuar, sepse taksat e qytetarëve nuk shkojnë atje ku qytetarët kanë nevojë. Ja pse paratë tuaja shkojnë në xhepat e miqve të Edi Ramës. Shqipëria ka pjesën më të madhe të popullsisë në varfëri, por për këtë qeveria ka menduar shumë pak, për të mos thënë aspak. Fondi i akorduar për ndihmën ekonomike, paaftësinë dhe papunësinë është më i vogël se vitin e kaluar, pra do të kemi një rënie konsumi. Propaganda prek edhe ish-të përndjekurit politikë, ku vlera e parashikuar është simbolike, pra do të duhen më shumë sesa 40 vjet për t'i likuiduar. Shqipëria ka deficitin tregtar më të lartë në rajon dhe Europë me mbi 30-40%. Rritja e akcizës për hidrokarburet, tullat, heqja e rimbursimit të TVSH-së do ta thellojë deficitin tregtar. Sot borxhi publik është mbi 90%. Brenda muajit që shkoi ne kemi marrë 850 milionë euro borxh, pra kemi marrë borxh për të paguar borxhin.

Sot kemi detyrimet e prapambetura ose borxhin e fshehur, i cili shkon në 1 miliard lekë. Vetëm borxhi i ujësjellësit të Durrësit, i cili ka një vlerë prej 52 milionë lekë të papaguara, do të mjaftonte për të ndërtuar të gjithë infrastrukturën e shpërndarjes së energjisë dhe për ta bërë bashkëkohore për të gjithë qarkun e Dibrës. Qeveria duhet të rrisë konsumin të qytetarët si indikator kryesor i tejkalimit të krizës, normalisht nuk e ka bërë, por ka bërë rritjen e PPP-ve. Në qarkun e Dibrës është mbi 60% të njëjësive vendore të palidhura me asfalt, ndërsa në gjysmën e qarqeve të Shqipërisë shpenzohen me miliona euro për PPP-të, ndërsa në qarkun e Dibrës dhe në katër bashkitë e saj, kemi hot spote skandaloze të mbetjeve urbane për të cilat nuk kanë paguar asnjë qindarkë as bashkitë dhe as qeveria "Rilindëse".

Të dashur qytetarë,

Paketa fiskale duhet të jetë një check and balance për zhvillimin e biznesit dhe të ardhurave në arkën e shtetit, por edhe konkurrese me vendet e rajonit. Është paketa më rënduese për biznesin shqiptar, sepse e ka TVSH-në 20%, pra ndër më të lartat në rajon. Kemi tatim-fitimin më të lartë në Europë, kemi akcizën më të lartë të naftës dhe të gazit në rajon dhe në Europë, por mbi të gjitha kjo është një paketë me subvencionimin më të vogël krahasuar me çdo vend të Europës. Në Shqipëri ka shkallë të lartë evazioni fiskal, ku 40-45% e prodhimit të brendshëm bruto ose rreth 1 miliard shkaktohet si evazion për shkak të paketës suaj fiskale. Duke marrë në konsideratë rritjen e çmimeve, krizës së krijuar nga Kryeministri dhe konkurrencës agresive të rajonit, prisim një paketë fiskale që të ishte më e ulët ose të ishte baras me vendet e rajonit, por, në fakt, kemi një paketë fiskale që e ka diskriminuar. Akciza me 60 lekë për gazin apo heqja e TVSH-së 10%, por edhe heqja e kompensimit, që është sot në fuqi me 6%, kanë bërë që të rritet akoma më tej rëndimi i ekonomisë.

Sot në rrethin e Dibrës groposen me tonelata fruta apo produkte të tjera bujqësore, sepse nuk ka treg, nuk subvencionohen dhe nuk ka fuqi blerëse. Taksa e karbonit 5 lekë për litër e vendosur në vitin 2012 rimbursohet 100%, rilindja e uli në 50% dhe sot do ta bëjë zero subvencionimin e saj. Shqipëria nuk ka një platformë të qartë për zhvillimin e biznesit dhe kjo meritë i shkon qeverisë tuaj, e cila pa dyshim mund të cilësohet si qeveria antibiznes. Bujqësia shikohet me syrin e njerks nga "rilindja". Qeveria vendos taksë kombëtare importi për qumështin pluhur për të mbrojtur prodhimin vendas. Po cilin prodhim vendas? A ka blegtori sot në Shqipëri? A e dini ju që ne sot kemi mesataren më të ulët të blegtorisë për numër popullsie jo vetëm në rajon, por edhe në botë? Pse nuk përdoret skema e vendeve të rajonit, për shembull e Maqedonisë së Veriut, për subvencionimin e blegtorisë dhe bujqësisë, për të cilën duhet të aplikohet një taksë. Pse nuk subvencionohet 10 lekë për litër qumështi apo pse nuk subvencionohet me euro për kokë blegtori, apo euro për kuintalë produkte bujqësore, e cila do të ishte një zgjidhje. A e dini ju që 11% e sasisë së qumështit formalizohet në treg dhe 89% e saj është informale? Normal që nuk e dini, sepse ministrja e ka mendjen tek akademia e barinjve! Për shkak të paketës fiskale diskriminuese për gazin, naftën, energjinë, karbonin, që zënë rreth 36% të

shpenzimeve, ne importojmë tulla, edhe pse kemi fabrika tullash, importojmë çimento, edhe pse kemi fabrikë çimentoje, importojmë qumësht nga Serbia, Bosnja, Maqedonia dhe Kosova për shkak të keqqeverisjes. Pagesa e TVSH-së në doganë është anormale, ajo duhet paguar kur ndodh shitja dhe kur rritet vlera, sepse përndryshe do të krijojë situatë anormale për qytetarët. Nga përvoja rajonale dhe europiane miratimi i një norme të reduktuar të TVSH-së për artikujt e shportës do të ishte zgjidhja më e mirë oportune. Kemi pagën mesatare me produktivitetin më të ulët në Europë. Konkurrueshmëria e prodhimit vendas me rajonin dhe atë global ngelet shqetësuese sot në Shqipëri.

Inovacioni në Shqipëri është në vendnumëro. Të ribëhet paketa fiskale me grupet e interesit dhe me ekspertët, në mënyrë që të jetë gjithëpërfshirëse, për ta bërë politikën fiskale reformuese kombëtare, për zhvillimin e biznesit konkurrues dhe të barabartë me vendet e rajonit, e cila do të ndikojë në reduktimin e çmimeve të mallrave të konsumit jetik, në përcaktimin e saktë të minimumit jetik dhe të dinjitetit të shqiptarëve. Nëse nuk i reflektoni këto çështje, atëherë mjerë shqiptarët! Ju i keni dënuar ata me rrënim e varfëri, Zoti i shpëtoftë shqiptarët nga Rilindja!